

SUELA PETRITAJ

**VËSHTRIM SASIOR MBI DISA ÇËSHTJE SINTAKSORE
NË GJUHËN SHQIPE: PARASHTRIMI I PROBLEMIT DHE
METODOLOGJIA E STUDIMIT**

Varieteti standard i sanksionuar më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit ishte një përzgjedhje e fortë politike. Në periudhën e sistemit totalitar në Shqipëri nisi të imponohej modeli vokal i toskërishtes, pavarësisht mungesës së normave ortoepike duke u krijuar parakushtet për një mbivlerësim të dialektit jugor dhe një stigmatizim të atij verior. Këtë çështje e kanë trajtuar disa autorë, nga të cilët po përmend këtu prof. Ardian Marashi, prof. Shezai Rrokaj, prof. Seit Mansaku, Akademik Kolec Topalli, Ledi Shamku-Shkreli etj.

Gjuha shqipe ka hyrë sot në një fazë zhvillimi të vrullshëm, sepse rrethanat dhe qëllimet mbas kodifikimit të saj në vitin 1972 kanë ndryshuar rrënjësisht, kjo për faktin se gjuha shqipe nuk është e izoluar në kushtet e procesit të lëvizjes së lirë dhe të integriteteve globale, ndaj përpara komunitetit shkencor shtrohet detyra e matjes sasimore të tipareve që kanë pësuar ndryshime me kohën dhe përcaktimi i tipareve, të cilat duhen përqafuar në rrugëtimin e tyre të ndryshuar. Me këtë pyetje merret edhe studimi ynë, i cili orvatet të bëjë disa matje sasimore të disa prej tipareve sintaksore të identifikuar nga **Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe** gjatë viteve të fundit. Ky studim synon të japë ndihmesën e tij me prurje e matje shkencore në diskutimet në lidhje me propozimet e këtij Këshilli.

Sikurse dihet, Universiteti i Tiranës në dhjetor të vitit të kaluar mori përsipër hapjen e një platforme diskutimi të gjerë me ftesa për albanologë brenda e jashtë vendit në ndihmë të konkretizimit të propozimeve të nxjerra nga **Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe**. Diskutimet qenë të larmishme e të thelluara dhe shumica e tyre konvergjuan në një pikë të përbashkët, atë të ndërmarrjes së studimeve të thelluara shkencore për të vëzhguar ndryshimet reale, që kanë ndodhur në procesin normatizues të shqipes standarde në harkun kohor 40-vjeçar pas mbledhjes së Kongresit të Drejtshkrimit.

Edhe me herët mendimi për ndryshimet në normën e shqipes ka qenë i larmishëm. Prof. Ardian Marashi, për shembull, në veprën “Shqipja në etapën e sotme“, të vitit 2011 shprehet se duhet të kemi një kontroll efektiv mbi mënyrën si funksionon gjuha, duke lënë mënjatë procesin vetëm të përshkrimit të sistemit dhe historikut të gjuhës dhe të fokusohemi te çështja e politikave të planifikimit gjuhësor, në procesin e rishikimit të një standardi detyrues të ndryshuar përmes pasurimit të tij nga a) prodhimi i sotëm letrar e shkencor b) nga dukuritë e reja të aspektit sociolinguistik dhe të pragmatikës gjuhësore c) nga prurjet dialektore dhe të folmet bisedore.

Prof. Shezai Rrokaj, në veprën “Çështje të gjuhës shqipe 2”, të vitit 2009 thekson se në vend që të merremi me diskutime shterpe për mënyrën se si u arrit njësimi i sotëm, se çfarë u mor dhe nuk u mor për bazë, duhet të fillojmë të reagojmë me vetëdijen e vetëmbrojtjes për ruajtjen e fjalëve gjegjëse brenda gjuhës, duke shmangur trysninë e vërshimit në gjuhën shqipe të fjalëve dhe strukturave të huaja dhe kjo realizohet përmes një politike gjithëpërfshirëse gjuhësore të standardit anekënd masës së folësve.

Prof. Seit Mansaku në veprën “Shqipja në etapën e sotme”, të vitit 2011 parashtron faktin se standardi në sferat mbizotëruese të tij dhe në funksionet e tij të kufizuara duhet pasuruar me vlera të reja, duke mos u bazuar gjithmonë te teoria e një përzierjeje mekanike të trajtave gramatikore nga të dyja dialektet, sepse kjo do të çonte në një standard të panatyrshëm dhe artificial, por përmes ndërmarrjes së studimeve serioze dhe ndërhyrjeve të ekuilibruara, duke ruajtur tiparin e qëndrueshmërisë së tij për një kohë të gjatë.

Akademik Kolec Topalli, në veprën “Shqipja në etapën e sotme”, të vitit 2011 thekson se ekzistenca e problemeve do të thotë një domosdoshmëri e rishikimit të disa rregullave të drejtshkrimit dhe të gjitha kontradiktat e krijuara në rregullat e drejtshkrimit duhet të hulumtohen dhe të bëhen ndryshimet përkatëse nga grupi i specialistëve dhe këto ndryshime të sanksionohen me ligj dhe pas këtij të botohet një fjalor drejtshkrimor i ri dhe një fjalor i gjuhës shqipe.

Prof. Mehmet Çeliku në veprën “Shqipja në etapën e sotme”, të vitit 2011 parashtron kërkesën për një konceptim të ri e më rezultativ në mësimdhënie dhe së fundmi kërkohet një mbështetje institucionale për studimin, pastrimin dhe pasurimin e standardit.

Shumë pak nga këto mendime e studime janë shoqëruar me vjelje e matje konkrete sasiore të cilat kanë rëndësinë e tyre në përcaktimin e ndryshimeve reale që po pëson shqipja. Ky studim synon të sjellë të dhëna empirike me matje sasiore për 6 nga tiparet sintaksore të propozuara nga **Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe** si tipare, të cilat po pësojnë ndryshime në shqipe. Më konkretisht, ky studim **do të masë** përqindjen e pranueshmërisë së varianteve të normës dhe të varianteve jashtë norme. Kampion studimi në këtë rast kanë qenë 100 nxënësit e klasave të X të gjimnazit “Babë Dudë Karbunara” dhe gjimnazit “Kristaq Capo” në qytetin e Beratit. Gjashtë çështjet sintaksore të trajtuara këtu janë si më poshtë:

1. Mospërsëritja e parafjalëve, e nyjeve të gjinore e pjesëzave formëformuese në ligjërimin e folur edhe të shkruar

Sot në gjuhë e folur, si dhe në disa stile të gjuhës letrare konstatohet prirja për mospërsëritjen e parafjalëve, të nyjave në gjinore, si dhe të pjesëzave trajtëformuese përpara gjymtyrëve homogjene dhe kjo ndodh për shkak të ligjëritit të folur, i cili rrjedh më shpejt në dhënien e informacionit apo për arsye të ndryshme stilistike.

A) Mospërsëritja e nyjës së përparme në gjinore

Përfaqësuesit e Italisë, Kroacisë, Bosnje-Hercegovinës në samitin e G8 nuk e aprovuan pavarësinë e Kosovës.

B) Mospërsëritja e pjesëzës formëformuese “për të”

Vështrim sasior mbi disa çështje sintaksore në gjuhën shqipe...

Të gjithë pjesëtarët e rajonit nr. 6 në Tiranë kundërshtuan vendimin e Minibashkisë për të paguar taksat e gjelbërimit, taksat e pastrimit dhe të ndriçimit.

C) Mospërsëritja e parafjalës “mbi”

Nata kishte shtrirë hijen e saj mbi tjegullat e shtëpive, fletët e pemëve, kreshtat e maleve.

2. Ndikime nga gjuhë të tjera vërehen edhe në rendin e gjymtyrëve të fjalisë

I tillë besoj se është vendosja e kryefjalës para kallëzuesit në disa tipe fjalish me lidhëza a fjalë lidhëse që parapëlqejnë të ndiqen nga kallëzuesi.

Gjuha shqipe karakterizohet nga dy lloje rendesh: A) Rendi i drejtë dhe rendi i anasjelltë. Në ditët e sotme rendi i anasjelltë kryefjalë-kallëzues po merr përparësi të dukshme, kryesisht në fjalitë e varura ftilluese, përkundrajt rendit të zakonshëm të shqipes kallëzues-kryefjalë.

A) Rendi i vendosjes së kryefjalës para kallëzuesit në fjalinë e nënrenditur ftilluese

Jo vetëm marrja e statusit kandidat në BE do të sjellë përfitime, siç shqiptarët besojnë, por edhe impenjimi në realizimin e tyre është shumë i rëndësishëm.

3. Përdorimi i paskajores “për të punuar” me funksion kundrinor

Sot, në botimet e gazetave, si dhe në shtypin e përditshëm po gjen zbatim të gjerë përdorimi jashtë norme i paskajores me funksion kundrinor p.sh.: Ajo kishte ëndërruar përherë për të punuar në një kompani shërbimesh.

4. Përdorimi i gabuar i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë

A) Përdorimi i trajtës së shkurtër *i* të rasës dhanore njëjës në vend të trajtës së shkurtër *u* të shumës të rasës dhanore

Sot, në median e shkruar dhe në atë vizive konstatohet prirja e shpeshtë e përdorimit të gabuar të trajtës së shkurtër “*i*” të rasës dhanore njëjës në vend të trajtës së shkurtër “*u*” vetës së tretë shumës së rasës dhanore, në kundërshtim me trajtat normativizuese të paraqitura në pasqyrën e lakimit të përemrave vetorë dhe të trajtave të shkurtra të tyre në tekstin e “Gramatikës” p.sh.:

Dje në konferencën e mbajtur pranë hotel “Sheraton” i deklaruan pjesëmarrësve të ishin bashkëpunues në lidhje me reformat prondryshimeve në arsimin parauniversitar.

5. Përdorimi i lidhëzës ftilluese *se* në vend të lidhëzës *që* në bashkëvjajtje me foljet *dua*, *dëshiroj*, *urdhëroj*, *kërkoj*, *vendos*

Ndërtimet sintaksore me lidhëzën ftilluese *se* po gjejnë një përdorim të gjerë, përkundrajt ndërtimit sintaksor me lidhëzën ftilluese *që* në kundërshtim me aspektin normativ, sipas së cilit kur fjalia drejtuese ka si kallëzues a. folje që tregojnë dëshirë si: *dua*, *dëshiroj*, *pranoj*; b) folje që fitojnë kuptim dëshirë si: *kërkoj*, *besoj*; c) folje që tregojnë shprehje vullneti dhe që kanë valencë kundrine, të tipit nxitës a dëshiror si: *urdhëroj*, *vendos*, *ndaloj* etj., përdoret fjalia e nënrenditur me lidhëzën ftilluese *që*.

A) Lidhëza ftilluese *se* në shoqërim me foljen *urdhëroj*

Ministri i Arsimit dhe Sportit kishte urdhëruar se studentët e masterit profesional do të pranoheshin mbi bazën e një mesatareje të përcaktuar.

B) Lidhëza ftilluese *se* në raport me foljen *vendos*

Disa mësues kanë vendosur se librat janë të pamjaftueshëm për të hartuar orën mësimore.


6. Ndërtimi “përgjigjem në pyetjen tuaj” në kundërshtim me normën sintaksore “i përgjigjem pyetjes suaj”

Ndërtimi “I përgjigjem pyetjes suaj” është në përputhje me strukturën e shqipes, sepse ruajtja e gramatikalitetit të kësaj fjalie kërkon domosdoshmërinë e rimarrjes së kundrinorit të zhdrejtë përmes trajtës së shkurtër “i” të përemrit vetor. Duke u bazuar te ky konstatim sot pohohet me të drejtë se ndërtimi “Përgjigjem në pyetjen tuaj” nuk qëndron në asnjë rrethanë ligjërimore, sepse foljet për shkak të strukturës së tyre gramatikore kanë kontroll të rreptë mbi numrin e roleve tematike, si dhe në drejtimin rasor të tyre, ndaj folja *përgjigjem*, në gjuhë shqipe kërkon dy argumente, të cilëve u shënon përkatësisht rasën emërore dhe dhanore: *Dikush i përgjigjet dikujt*.

P.sh.: Përgjigjem në pyetjen tuaj duke shprehur mendimin personal në lidhje me këtë çështje.

Të gjashta këto çështje sintaksore u anketuan me pjesëmarrësit e përmendur më lart në formën e tyre brenda normës dhe në formën e tyre jashtë normës, pra në rastet e shmangieve sikurse do t'i përcaktonte edhe **Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe**. Pjesëmarrësve iu kërkua që të gjykonin nëse këto fjali iu tingëllonin mirë në shqip, ashtu sikurse e kërkon edhe vetë detyra e gjykimit të gramatikalitetit. Fjalitë u prezantuan të shkurtisura dhe jo në renditje të njëpasnjëshme në llojin e tyre.

Rezultatet e studimit të 6 çështjeve sintaksore



1) Nga paraqitja grafike rezulton se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës në strukturën “mospërsëritja e nyjës së përparme të gjinorës të” është 72%, ndërsa varianti jashtë normës rezulton 78%. Pra, rezultatet flasin për një pranueshmëri në shkallë të njëjtë të të dy varianteve. 2) Në strukturën


Vështrim sasior mbi disa çështje sintaksore në gjuhën shqipe...

“mospërsëritja e trajtave formëformuese *për të*” në variantin e normës pranohet në masën 76% kundrejt 69% të variantit jashtë norme. Pra, konstatohet se për këtë strukturë, kemi sërish një pranueshmëri në shkallë të njëjtë të variantit të normës dhe atij jashtë norme nga të anketuarit. 3) Në strukturën “Mospërsëritja e parafjalës *mbi*” kemi një barazim në përqindje të dy varianteve në masë 91%. Pra, të dhënat flasin për një pranueshmëri të lartë të variantit të normës, si dhe të atij jashtë normës.

Në çështjen sintaksore “Rendi i gjymtyrëve të fjalisë: Pozicioni i kryefjalës para




kallëzuesit në fjalinë e nënrenditur” konstatohet se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës është 65%, ndërsa e variantit jashtë norme është 49.5%. Diferenca e ulët në përqindje e të dy varianteve thekson një shkallë pranueshmërie afërsisht të njëjtë mes variantit të normës dhe të atij jashtë normës.




Në çështjen sintaksore “paskajorja *për të punuar me* funksion kundrinor” rezulton se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës është 90%, ndërsa pranueshmëria në përqindje e variantit jashtë normës është 39%. Nga të dhënat konstatohet se kemi një shkallë të lartë të pranueshmërisë së variantit të normës, si

dhe një përqindje të ulët nënmesatë të variantit jashtë normës, sepse diferenca e pranueshmërisë së dy varianteve është 50%, një përqindje relativisht e thellë.




Në çështjen sintaksore “Përdorimi i trajtës së shkurtër ‘i’ të rasës dhanore njëjës në vend të trajtës së shkurtër ‘u’ të shumësit të rasës dhanore” rezulton se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës është 79.5%, ndërsa pranueshmëria në përqindje e variantit jashtë normës është 74.5%. Nga të dhënat grafike konstatohet se kemi një shkallë pranueshmërie të njëjtë mes variantit të normës dhe variantit jashtë normës nga të anketuarit.



1) Nga të dhënat statistikore për çështjen sintaksore “Lidhëza ffilluese *se* në shoqërim me foljen *urdhëroj*” rezulton se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës është 85%, ndërsa e variantit jashtë normës është 95%. Pra, duke iu referuar të dhënave në përqindje për të dy variantet konstatohet se kemi një

Vështrim sasior mbi disa çështje sintaksore në gjuhën shqipe...

shkallë të njëjtë të pranueshmërisë së dy varianteve nga të anketuarit, pra në të njëjtën masë. 2) Në çështjen sintaksore “Lidhëza filluese *se* në raport me foljen *vendos*” rezulton se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës është 80%, ndërsa pranueshmëria në përqindje e variantit jashtë normës është 90%. Rezultatet tregojnë se si varianti i normës dhe varianti jashtë normës paraqiten në një shkallë të njëjtë të pranueshmërisë së tyre.



Duke iu referuar të dhënave statistikore për ndërtimin “Përgjigjem në pyetjen tuaj” në kundërshtim me normën sintaksore “I përgjigjem pyetjes suaj” rezulton se pranueshmëria në përqindje e variantit të normës është 74%, ndërsa pranueshmëria në përqindje e variantit jashtë normës është 29%. Nga të dhënat në përqindje të të dy varianteve rezulton se kemi një shkallë të ulët të pranueshmërisë së variantit jashtë normës nga të anketuarit, përkundrejt një shkalle relativisht më të lartë të pranueshmërisë së variantit të normës.

Përfundim

Duke iu referuar analizës statistikore të çështjeve sintaksore të sipërpërmendura, rezulton se në katër nga çështjet sintaksore të trajtuara kemi një shkallë pranueshmërie të njëjtë si të varianteve të normës, ashtu edhe të varianteve jashtë normës. Konstatohet se vetëm në dy ndërtimet sintaksore “Përdorimi i paskajores “për të” në funksion kundrinor” dhe ndërtimi “Përgjigjem në pyetjen tuaj” në vend të “I përgjigjem pyetjes suaj” rezulton një diferencë e thellë në raportin e pranueshmërisë midis të dy varianteve, duke pasur një shkallë mjaft të ulët nën 40% të pranueshmërisë të variantit jashtë normës. Të dhënat statistikore të pasqyruara shërbejnë si një tregues i procesit të vullshëm të pranueshmërisë së varianteve jashtë normës nga shqipfolësit dhe flasin qartë për shkallën e ndryshimeve reale të ndodhura në strukturën sintaksore dhe leksikore në gjuhën shqipe në procesin normativizues dhe kodifikues të saj, jo vetëm vitet e fundit, por edhe në ditët e sotme, prandaj shtrohet me të drejtë çështja e rishikimit të standardit përmes hartimit të politikave të planifikimit gjuhësor, si dhe të

ndërmarrjes së studimeve serioze në planin e rishikimit dhe rikodifikimit të disa normave të standardit.

BIBLIOGRAFI

- M. Çeliku, *Për një përmirësim të mëtejshëm të shqipes standard: Mbi ndryshimin e disa rregullave të "Drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, në "Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe pasurimit të standardit", QSA, Tiranë, 2011.
- Gramatika e gjuhës shqipe, I, Morfologjia*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002.
- Gramatika e gjuhës shqipe, II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002.
- F. Koleci, *Për një manual normativ e kodifikues të sintaksës*, në "Studime albanologjike" 1.
- S. Mansaku, *Nga gjuha letrare kombëtare te gjuha standard-Dallime terminologjike dhe përmbajtësore*, në "Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe pasurimit të standardit", QSA, Tiranë, 2011.
- A. Marashi, *Sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve*, në "Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe pasurimit të standardit", QSA, Tiranë, 2011.
- A. Omari, *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare*, në "Shqipja në etapë etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit", QSA, Tiranë, 2011.
- R. Rushiti, *Përdorimi i lidhëzave ffilluese se e që në ligjërimet e shkruara të shqipes standarde*, në "Studime albanologjike" 1.
- Sh. Rrokaj, *Dy mendime për disa përdorime jokorrekte të trajtës së shkurtër në gjuhën shqipe*, në "Çështje të gjuhës shqipe" 2.
- Sh. Rrokaj, *Shqipja në epokën e globalizmit*, në "Çështje të gjuhës shqipe" 2, Tiranë, 2009.
- L. Shamku - Shkreli, *Neostandardi i shqipes- Traditë dhe përtrimje*, në "Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit", QSA, Tiranë, 2011.
- K. Topalli, *Drejtshkrimi i shqipes si sistem*, në "Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit", QSA, Tiranë, 2011.

**GJUHËSI E ZBATUAR, DIALEKTOLOGJI,
SOCIOLINGUISTIKË**

